VENDIM EKSTRAKT

Për kriterin e pranueshmërisë nenin 120 pika 1, shkronjat "ç" dhe "dh" (shkelje disiplinore kur fillon hetimi)

Në përmbajtje të ankesave të paraqitura, ankuesi, Avokati i Popullit, parashtron se në Institucionin e tij ka paraqitur ankesë një i dënuar me burgim. Ai ka ngritur shqetësimin se nuk i ishte llogaritur si kohë e vuajtjes së dënimit, koha e qëndrimit të tij në burgun e një shteti tjetër, si dhe nuk kishte përfituar ulje dënimi nga ligji nr. 33/2024 "Për dhënie amnistie". Veçanërisht ankesa bëhet për mos llogaritjen e periudhës së qëndrimit të tij në paraburgim në shtetin tjetër në fazën fillestare të ekzekutimit të dënimit.

Avokati i Popullit ka parashtruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin e formës së prerë datë 04.02.2019, ka vendosur revokimin e dënimit alternativ të dhënë me vendimin e datës 15.07.2016 dhe ekzekutimin e dënimit me 2 vite burgim. Fillimisht, ekzekutimi i dënimit ishte pezulluar dhe i dënuari ishte vënë në provë për një periudhë 2 vjeçare, më pas, me vendim shtetasi u dënua edhe me 3 muaj burgim për veprën penale "Veprime në kundërshtim me vendimi në gjykatës".

Pas ekstradimit të të dënuarit nga shteti i huaj, është ndjekur procedura për bashkimin e dy dënimeve. Në kuadër të kësaj procedure, gjykata ka kërkuar informacion për dinamikën e vuajtjes së dënimit dhe dokumentacionin e ekstradimit, përfshirë të dhënat lidhur me periudhën e paraburgimit në shtetin e huaj.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur bashkimin e dënimeve dhe caktimin e një dënimi të vetëm prej 2 vitesh burgim. Në vendim është përcaktuar se ekzekutimi i dënimit do të fillojë nga dita e vendimit përfundimtar, që kishte vendosur bashkimin e dënimeve për të vuajtur edhe 11 muaj e 20 ditë burgim.

Pas paraqitjes së ankesë nga i dënuari pranë Avokatit të Popullit dhe kërkesës për informacion drejtuar prokurorisë, u administrua dokumentacioni i plotë e ekstradimit. Nga ky dokumentacion rezultoi se shtetasi ishte arrestuar në shtetin e huaj më datë 15.06.2022 dhe kishte qëndruar në paraburgim atje deri më datë 12.07.2023, kur u ekstradua në Shqipëri. Kjo periudhë, prej 1 viti, 7 muaj e 12 ditë, duhej të merrej në konsideratë për efekt të llogaritjes së dënimit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ekstradimit, prokuroria konstatoi se periudha e paraburgimit në shtetin e huaj duhej zbritur nga koha e përgjithshme e dënimit. Për rrjedhojë, vlerësoi se shtetasi kishte përmbushur dënimin përpara dhënies së vendimit për bashkimin e dënimeve. Avokati i Popullit pretendoi se mos llogaritja në kohën e duhur e periudhës së paraburgimit në shtetin e huaj, kishte sjellë vuajtjen e padrejtë të dënimit nga shtetasi për një periudhë prej 9 muaj e 18 ditë, dhe se ky burgim i padrejtë ka ndodhur për arsye se prokurori i ekzekutimeve nuk ka llogaritur në masën e dënimit, kohën e qëndrimit të tij në paraburgimin e shtetit të huaj.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konstatoi se ato plotësonin kriteret formale të pranueshmërisë, por se të dhënat nuk ishin të mjaftueshme për të justifikuar drejtpërdrejtë fillimin e hetimit disiplinor. Për këtë arsye, me vendimin e datës 05.05.2025, u

vendos verifikimi i ankesave dhe administrimi i dokumentacionit të plotë të ekzekutimit të dënimit dhe të dosjes gjyqësore që lidhej me bashkimin e dënimit të shtetasit.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesave rezultoi se këto ankesa nuk përmbanin fakte të qarta dhe të mjaftueshme, si dhe nuk ishin shoqëruar me prova të cilat justifikonin fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 122, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin disiplinor nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor.

Lidhur me veprimtarinë e gjyqtarit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerësoi se në rastin konkret krijohet *dyshim i arsyeshëm* për mosrespektimin e detyrimit për arsyetimin e vendimit dhe për çmuarjen e provave të administruara, lidhur me parashikimet e neneve 112, 152, 380, 382 të Kodit të Procedurës Penale. Moszbatimi i këtyre detyrimeve passjell përgjegjësi disiplinore për magjistratin për shkelje disiplinore të parashikuar në nenin 102, pika 2, shkronja "c" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, që lidhet me nxjerrjen e akteve të paarsyetuar ose me arsyetim të pamjaftueshëm në rastet kur ligji kërkon arsyetimin e tyre.

Lidhur me veprimtarinë e prokurorit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë në analizë të dokumentacionit dhe të dhënave të administruara gjatë procesit të verifikimit rezulton se magjistrati me detyrë prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjatë procedurës për bashkimin e dënimeve, në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, nuk ka paraqitur kërkesë për njohjen e periudhës së paraburgimit të kryer nga ana e të dënuarit në shtetin tjetër, për efekt të llogaritej në masës e dënimit. Në të njëjtën kohë, ky fakt nuk është mbajtur në konsideratë edhe gjatë nxjerrjes së Urdhrit të Ekzekutimit, datës 22.07.2024, ndonëse dokumentacioni përkatës i ekstradimit ishte kërkuar dhe ishte administruar gjatë procesit gjyqësor. Përllogaritja e periudhës së paraburgimit u krye vetëm pas kërkesës së drejtuar nga Avokati i Popullit.

Inspektori vlerësoi se në këto rrethana, krijohej *dyshimi i arsyeshëm* se nga ana e magjistratit me detyrë prokurore nuk janë përmbushur në kohën e duhur detyrimet që lidhen me mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit penal dhe me llogaritjen e periudhës së paraburgimit në nenet 24, 465, 469 dhe 504, pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nenin 51 pika 3, të ligjit 10193/2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritete e huaja në çështje penale", të ndryshuar.

Në këtë vlerësim u mor në konsideratë edhe fakti se prokurori kishte urdhëruar lirimin e të dënuarit, pasi kishte konstatuar se periudha e paraburgimit në shtetin e huaj, duhej zbritur nga dënimi i përfundimtar. Mbështetur në argumentet sa më sipër, moszbatimi i këtyre detyrimeve passjell përgjegjësi disiplinore për magjistratin për shkelje disiplinore të parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronjat "ç" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 133, 138 te ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokuroreve Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe neneve 194 dhe 214, pika 7, shkronja "a" të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

VENDOSA

1. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kohën e kryerjes së shkeljes disiplinore, për shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 102. pika l, shkronjat "ç" dhe "dh" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kohën e kryerjes së shkeljes disiplinore.
3. Propozimin e masës disiplinore parashikuar nga neni 105, pika l, shkronja ndarja "i" dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Njoftimin e magjistrates me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor ndaj saj për shkeljet disiplinore të përcaktuara me sipër.
5. Njoftimin e institucionit të Avokatit të Popullit në cilësinë e ankuesit lidhur me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor, në rastin konkret ndaj magjistrates.
6. Dërgimin e Raportit te Hetimit Disiplinor ës bashku me dosjen hetimore dhe Vendimin për përfundimin e hetimit disiplinor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.